



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 726/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me apelet e parashtruara nga Myrvete Avdullahu, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik Nisma për Kosovë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara apelet ZL Anr 726/2017, ZL Anr 727/2017, ZL Anr 728/2017, ZL dhe ZL Anr 729/2017 të parashtruar nga Myrvete Avdullahu, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik Nisma për Kosovë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar apelet ZL Anr 726/2017, ZL Anr 727/2017, ZL Anr 728/2017, ZL dhe ZL Anr 729/2017, të parashtruara nga Myrvete Avdullahu, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik Nisma për Kosovë, dega në Lipjan në të cilat pretendon se në qendrat e votimit 1322E, 1302E, 1305E, 1327E qëllimisht i janë keqpërdorur votat duke ju bartur kandidatëve tjere nga kryesuesit e këtyre qendrave të votimit.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar apelet dhe i ka trajtuar si një apel të evidentuar me ZL Anr. 726/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha apelet vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së apeleve dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apelet janë të pabazuara

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesja e apeleve nuk ka paraqitur ndonjë prove llidhur me pretendimet e parashtruara, si dhe nuk ka specifikuar se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimeve të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 10.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apelet në fjalë janë të pa argumentuar me fakte dhe si të tilla janë të pabazuara.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.A.nr. 726/2017 me datën 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.